



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 825/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hanife Salihu, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër komisionarëve në fshatin Koshare të Ferizajt, për shkak të parregullsive dhe të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e parregullt ankesa e Hanife Salihu, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11.11.2013, nga Hanife Salihu, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendon se për arsye të keqpërdorimit të votave në këtë vendvotim si dhe manipulimit të votave brenda vendvotimit kërkon që të numërohen edhe njëherë votat e secilit kandidat.

PZAP-i, shqyrtoi ankesën, gjeti se:


Ankesa është e parregullt

Nga shkresat e lendes PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se formulari i ankesës nuk përmbush kushtet e parapara në bazë të nenit 3.6 pika d) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e ku thuhet se të gjitha ankesat duhet të kenë së paku informacionet vijuese, vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës, andaj për këtë arsye duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në nenin 118.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 825/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.